

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7892
E enjte, 26 shtator 2024
Çmimi 0.50

Koalicionet normale dhe jonormale për zgjedhjet e 9 shkurtit



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

'NËSE DO TË BASHKOHESH NË NJË KLUB, MOS URINO NË DERËN E KLUBIT', HOVENIERI I DËRGON POROSI QEVERISË SË KOSOVËS.

FAQE 4-5



Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se Shtetet e Bashkuara presin që Kosova dhe Serbia ta marrin seriozisht dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Hovenieri tha se të dyja palët duhet

patjetër t'i zbatojnë të gjitha detyrimet e dala nga ky dialog, i cili nisi më 2011 në Bruksel. Hovenieri ka theksuar se për ta arritur anëtarësimin e plotë në NATO dhe BE, Kosova duhet ta sigurojë miratimin e të gjitha vendeve anëtare. Në

një deklaratë të mëtejshme, Hovenieri përmendi një shprehje të gjyshit të tij, duke ilustruar rëndësinë e qasjes së kujdesshme në proceset diplomatike. "Nëse dëshiron të bashkohesh në një klub, mos urino te dera e klubit"

SHTYHET SEANCA FILLESTARE PËR RASTIN E SULMIT NË BANJSKË

F.3



HARADINAJ ME PARTNERËT E KOALICIONIT PARAQESIN PROGRAMIN ZGJEDHOR

F.7

AKTUALE



TRUMPI U NJOFTUA PËR KËRCËNIMET E DYSHUARA NGA IRANI PËR TA VRARË ATË, THONË NGA FUSHATA E TIJ

F.2

SVEÇLA THOTË SE REFORMIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE ËSHTË KYÇ PËR RRRUGËN E KOSOVËS DREJT BE-së

F.5

BRITANIA DËRGON PERSONEL DHE AUTOMJETE NË KOSOVË PËR STËRVITJE ME KFOR-in

F.7

EKONOMI



CEFTA, MINISTRI GJERMAN: PO PËRPIOEMI TË GJEMË NJË ZGJIDHJE PËR KOSOVËN

F.8

GUVERNATORI I BQK-së THOTË SE EKONOMIA E KOSOVËS KA SHËNUAR RRIJTJE PREJ 3.3-PËRQINDËSH

F.8

SPORT



TAKIM I RËNDËSISHËM PËR LOJËRAT MESHDETARE 'PRISHTINA 2030' NË ATHINË

F.10

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi u njoftua për kërcënimet e dyshuara nga Irani për ta vrarë atë, thonë nga fushata e tij

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Zyrtarët e inteligjencës amerikane e njoftuan të martën ish-presidentin amerikan Donald Trump për kërcënimet e dyshuara nga Irani për ta vrarë atë, tha fushata e kandidatit republikan. "Presidenti Trump u njoftua sot nga Zyra e Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare në lidhje me kërcënimet e vërteta dhe specifike nga Irani për ta vrarë atë, në përpjekje për destabilizim dhe për të shkaktuar kaos në Shtetet e Bashkuara", tha fushata e Trumpit në një komunikatë të martën. Ajo tha se zyrtarët e inteligjencës kanë zbuluar se kërcënimet iraniane "janë rritur në muajt e fundit" dhe



se zyrtarët e qeverisë amerikane janë duke punuar për ta mbrojtur Trumpin dhe për t'u siguruar se zgjedhjet nuk do të ndikohen. Trumpi tha më herët në faqen e

vet Truth Social se Irani përbën "kërcënim të madh" për jetën e tij, duke shtuar se përpjekjet e Iranit ishin të pasuksesshme "por ata do të tentojnë përsëri".

Irani e ka mohuar në të kaluarën çdo pretendim të ShBA-së se po ndërhyr në çështjet amerikane. Autoritetet amerikane janë duke i hetuar ndaras një tentim për ta vrarë Trumpin në fushën e tij të golfit në Floridë në shtator, dhe një incident me të shtëna në tubimin e kandidatit republikan për president më 13 korrik në Pensilvani.

Nuk ka tregues se Irani ka qenë i përfshirë në ndonjërin prej këtyre incidenteve. Byroja Federale e Hetimeve (FBI) dhe agjencitë e tjera federale të Shteteve të Bashkuara thanë javën e kaluar se hakerët iraniane u dërguan emaile të pakërkuara

individëve të lidhur me fushatën e presidentit Joe Biden për zgjedhjet e nëntorit, të cilat përmbanin pjesë të të dhënave të vjedhura dhe jopublike të fushatës së Trumpit. Ato thanë se kjo ishte një tjetër përpjekje e Teheranit për të ndikuar në zgjedhjet në ShBA. Bideni ishte kandidat demokrat deri më 21 korrik, kur njoftoi se u tërhoq nga gara dhe e mbështeti Kamala Harrisin si zëvendësuese të tij.

Në gusht Shtetet e Bashkuara e akuzuan Iranin se kreu operacione kibernetike kundër fushatave të dy kandidatëve për president amerikan. Irani i mohoi akuzat.

ShBA-ja 'e shqetësuar' nga sulmi i Hezbollahut në Tel Aviv

UASHINGTON, 25 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të shqetësuara nga raportimet se Hezbollahu - grupi libanez i shpallur organizatë terroriste nga Uashingtoni - ka gjuajtur një raketë që kishte për shënjestër shërbimin e inteligjencës të Izraelit.

Zëdhënësi për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, tha se ShBA-ja ende beson se një zgjidhje diplomatike mund t'i ulë tensionet në kufirin Liban-Izrael. "Shumë shqetësuese", tha Kirby në një intervistë për CNN. "Provë tjetër... se Izraeli po përballet me kërcënim legjitim nga një grup terrorist që mbështetet nga Irani". Kirby tha se ShBA-ja do të vazhdojë ta mbështesë të drejtën e Izraelit për ta mbrojtur veten. "Asnjë komb nuk duhet të jetojë në kërcënime të tilla që vijnë përtej kufirit, nga fqinjët", tha ai.

Mëngjesin e 25 shtatorit Hezbollahu gjuajti një raketë balistike drejt Tel Avivit, duke përshkallëzuar edhe më tej situatën. Një ditë më herët ushtria izraelite bombardoi Libanin, teksa ditët e fundit si pasojë e sulmeve izraelite janë vrarë qindra persona në Liban.

Ushtria izraelite tha se e rrëzoi një raketë balistike tokë-tokë dhe aktivizoi sirenat për sulme ajrore në Tel Aviv, duke mos raportuar për viktima apo dëme. Hezbollahu tha se e gjuajti raketën balistike të llojit, Qader 1, drejt selisë qendrore të agjencisë izraelite të inteligjencës, Mossad. Hezbollahu dhe Izraeli kanë këmbyer zjarr përditë që kur ka nisur lufta në Gazë në tetor në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian.



Kina teston një raketë balistike ndërkontinentale

PEKIN, 25 SHTATOR - Kina tha se ka testuar një raketë balistike ndërkontinentale më 25 shtator. Raketa, që u gjuajt në Oqeanin Paqësor, paraqet testimin e parë të këtij lloji që Kina ka kryer në dekada.

Lëshimi i kësaj rakete nxit kundërshtimin e shteteve të tjera në rajon, teksa Japonia tha se Kina nuk e kishte njoftuar paraprakisht për këtë testim, duke shprehur "shqetësim të thellë" për grumbullimin ushtarak të Pekinit.

Pekini ka rritur zhvillimin bërthamor dhe ka rritur shpenzimet në fushën e mbrojtjes në vitet e fundit. Tetorin e kaluar Pentagoni paralajmëroi se Kina po zhvillon arsenalin e saj



bërthamor më shpejt sesa kishte parashikuar ShBA-ja. Kina ka më shumë se 500 koka operacionale bërthamore që nga maji i vitit 2023 dhe me gjasë do të ketë mbi 1 000 të tilla deri më 2030, tha ShBA-ja. Forcat raketore të ushtrisë kineze "lëshuan një raketë balistike ndërkontinentale... që kishte një kokë të rreme bërthamore dhe raketa u gjuajt në Oqeanin Paqësor në orën 08:44 më 25 shtator dhe raketa ra në zonën detare që ishte parashikuar", tha Ministria e Mbrojtjes e Kinës.

Kjo ministri e cilësoi këtë testim si "rutinor" dhe tha se "ishte pjesë e planit tonë vjetor të stërvitjeve". "Është në linjë me ligjin ndërkombëtar dhe

praktikat ndërkombëtare dhe nuk ishte drejtuar kundër asnjë shteti apo ndonjë caku".

Përveç Japonisë, edhe Australia shprehu zemërim për këtë veprim të Kinës, duke kërkuar "shpjegim" nga Pekini, pasi tha se ishte e shqetësuar "nga çdo veprim që mund të destabilizojë dhe ta rrisë rrezikun e keqlllogaritjes" në rajon.

Zelanda e Re, po ashtu, tha se lëshimi i raketës, që ra në Paqësorin Jugor, ishte "zhvillim shqetësues". Pekini për herë të parë kishte kryer testim të një rakete balistike

ndërkontinentale në Paqësorin Jugor në vitet '80. Që atëherë Kina kryesisht ka kryer teste të tilla në hapësirën e vet ajrore.

Shtyhet seanca fillestare për rastin e sulmit në Banjskë



PRISHTINË, 25 SHTATOR - Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi ta shtyjë seancën fillestare në rastin Banjska kundër 45 të akuzuarve për terrorizëm dhe për vepra të rënda kundër Kushtetutës së Kosovës, përfshirë Millan Radoiçiqin, ish-nënkretar i Listës Serbe.

Një seancë e re u caktua për 9 tetor, pas kërkesës së tre avokatëve të të akuzuarve që gjenden në paraburgim. Ata donin më shumë kohë për t'u përgatitur.

Në paraburgim në Kosovë ndodhen vetëm tre persona që u arrestuan gjatë sulmit në Banjskë: Vladimir Toliq, Blagoje Spasojeviq dhe Dushan Maksimoviq.

Shumica e të akuzuarve ndodhen në arrati.

Prokuroria konfirmoi se të pranishëm në seancën e së mërkurës ishin vetëm tre të pandehur dhe kërkoi që të sigurohet prania e të gjithë të akuzuarve, ose që ata të gjykohej në mungesë.

Derisa prokuroria tha se ndryshimet në Kodin Penal e mundësonin gjykimin në mungesë, Lubomir Pantoviq, avokati i të arrestuarit Blagoje Spasojeviq, theksoi se nuk ekzistonte bazë ligjore për një gjë të tillë.

Avokatët e të akuzuarve kërkuan nga prokuroria t'ua dorëzojë

dosjet e rastit në formë fizike, pasi disa dosje të pranuar në mënyrë elektronike "nuk kanë mundur t'i hapin" dhe se nuk mund të përgatiten për mbrojtje, prandaj kërkuan që seanca të shtyhej.

Prokuroria kërkoi që seanca të shtyhej vetëm nëse të pandehurit do ta praninin fajësinë, gjë që nuk u pranua nga gjykatësi. Megjithatë, të pandehurit do të deklarohen rreth fajësisë në seancën e re muajin e ardhshëm.

Avokati i palës së dëmtuar, Arianit Koci, i kërkoi gjykatës ta shqyrtojë gjykimin e të gjithëve në mungesë, duke argumentuar se veprat për të cilat akuzohen ata janë specifike dhe se të pandehurit mund ta rrezikojnë sigurinë e Kosovës.

Gjyqtari Arben Hoti njoftoi se do të kërkojë mendim juridik nga Gjykata Supreme për interpretimin e ligjit kur bëhet fjalë për gjykimin në mungesë.

Gjykata vlerësoi se tani dhe në të ardhmen ekzistojnë kushtet për gjykimin e atyre që ndodhen në paraburgim.

Kjo seancë vjen një ditë pas përvjetorit të sulmit në Banjskë, në veri të Kosovës, kur një grup i armatosur serb sulmoi policinë dhe vrau rreshterin Afrim Bunjaku. Në shkëmbimin e zjarrit që pasoi u vranë edhe tre sulmues serbë.

Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiçiq, ish-nënkretar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë e cila ka mbështetjen e Beogradit zyrtar. Besohet se ai dhe anëtarët e tjerë të këtij grupi të armatosur ndodhen në Serbi.

Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë (REL), më 24 shtator, tha se ligjet e Kosovës lejojnë që të gjykohej në mungesë, dhe se Serbia "herët a vonë do të detyrohet ta dorëzojë Radoiçiqin dhe të tjerët".

Lubomir Pantoviq, avokati i të arrestuarit Spasojeviq, javën e kaluar i tha REL-it se gjyqi do të jetë "i vështirë, serioz dhe kompleks", pasi veprat penale të përmendura në aktakuzë janë të tilla.

Klienti i tij, Blagoje Spasojeviq, i ka treguar policisë disa detaje pas arrestimit, por theksoi se nuk e dinte se më 24 shtator 2023 do të ndodhte një sulm i armatosur. Ndërkohë, me sugjerimin e avokatit të tij, ai më vonë vendosi të mbrohet duke heshtur.

Çfarë thuhet në aktakuzë?

Prokuroria Speciale e Kosovës ngarkon të akuzuarit, ndër të

tjera, me vepra terroriste dhe vepra kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës. Më herët, prokurori Naim Abazi ka thënë se të akuzuarit kishin role të ndryshme brenda grupit kriminal nga organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri të financimi dhe pastrimi i parave.

Në aktakuzë thuhet se ky grup, përmes përdorimit të dhunës me armatim të rëndë, ka tentuar "ta shkëpusë pjesën veriore të territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht komunat e banuara me shumicë serbe, dhe këtë pjesë të territorit t'ia bashkojë Republikës së Serbisë".

Si lider i këtij grupi është identifikuar Millan Radoiçiq, për të cilin thuhet se ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe aktivitetet kriminale. Radoiçiq gjendet në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar për lidhjet me krimin e organizuar ndërkombëtar dhe korrupsionin. Në Kosovë, Radoiçiq gjithashtu lidhet me vrasjen e një politikani opozitar serb dhe frikësimin e dëshmitarëve në një proces gjyqësor që lidhet me ndërtimet ilegale.

Në aktakuzë, Prokuroria përmend 34 dosje me prova, në

mesin e të cilave ka video-incizime, analiza të pajisjeve elektronike, përgjigje të ndryshme nga Luksemburgu, Bosnjë-Hercegovina, bankat dhe institucione të ndryshme, deklarata të dëshmitarëve etj.

Hetimin e sulmit në Banjskë po e udhëheq edhe Prokuroria e Lartë Publike në Beograd, e cila ngarkon Radoiçiqin me tri vepra penale - ndër të cilat janë prodhimi i paautorizuar, posedimi, mbajtja dhe trafikimi i armëve të zjarrit dhe lëndëve shpërthyes, dhe vepra të rënda kundër sigurisë publike. Të dyshuarit e tjerë janë persona të panjohur (NN).

Autoritetet e Kosovës e konsiderojnë sulmin në Banjskë një akt terrorist dhe akuzojnë Serbinë se qëndron pas tij. Ministri Sveçla tha se ekzistojnë informacione të inteligjencës se të njëjtat grupe vazhdojnë të stërviten në territorin e Serbisë dhe rreth kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Nga ana tjetër, Serbia në disa raste ka mohuar çdo përfshirje, ndërsa presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka theksuar se për Beogradin ky sulm nuk është terrorist, por po hetohet. Bashkësia ndërkombëtare e ka dënuar ashpër sulmin në Banjskë dhe ka kërkuar hetim dhe që përgjegjësit të dalin para drejtësisë.

Konjufca priti në takim rrjetin e shoqatave ROSCAP dhe pranoi nismën legislative

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim Rrjetin e Organizatave të Shoqërisë Civile për Arsimin Parauniversitar (ROSCAP), të përbërë nga 14 organizata të

shoqërisë civile në vend. Në bazë të Ligjit për nisma legislative, kryetari Konjufca pranoi në mënyrë solemne nismën legislative të nënshkruar nga 10 mijë qytetarë, me propozimin për hartimin e projektligjit për

pensionimin e vullnetshëm të parakohshëm të mësimit në arsimin parauniversitar, si dhe për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për arsimin parauniversitar, të dorëzuar nga përfaqësues të ROSCAP.





‘Nëse do të bashkohesh në një klub, mos urino në derën e klubit’, Hovenieri i dërgon porosi Qeverisë së Kosovës

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se Shtetet e Bashkuara presin që Kosova dhe Serbia ta marrin seriozisht dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Hovenieri tha se të dyja palët duhet patjetër t'i zbatojnë të gjitha detyrimet e dala nga ky dialog, i cili nisi më 2011 në Bruksel. Hovenieri ka theksuar se për ta arritur anëtarësimin e plotë në NATO dhe BE, Kosova duhet ta sigurojë miratimin e të gjitha vendeve anëtare. Në një deklaratë të mëtejshme, Hovenieri përmendi një shprehje të gjyshit të tij, duke ilustruar rëndësinë e qasjes së kujdesshme në proceset diplomatike. “Nëse dëshiron të bashkohesh në një klub, mos urino te dera e klubit”

që ta bëjnë të dyja palët”, shtoi ai. Kryenegociatori i Kosovës dhe ai i Serbisë udhëtuan në Bruksel më herët këtë muaj, por ata nuk mbajtën takim të përbashkët për shkak të mospajtimeve rreth temave që do të duhej t'i shtjellonin. Ndërkohë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, janë takuar për herë të fundit më 14 shtator të vitit 2023 për shkak të mospajtimeve të dukshme.

Kosova e akuzon palën serbe se dëshiron vetëm zbatimin e pjesëshëm të Marrëveshjes Bazë, ndërsa Serbia e kritikoi palën e Kosovës se nuk dëshiron ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, që është pjesë e pajtimit.

Hovenieri tha se Kosova dhe Serbia duhet të punojnë për përfitime të përbashkëta nga dialogu, dhe jo të kërkojnë të jenë fituesi i vetëm. “Ky është proces. Duhet të punohet për të arritur përfitime reciproke. Shtetet e Bashkuara duan që kjo të ndodhë pa asnjë kompromis dhe kjo është thelbësore për Kosovën. Nuk do të ishte fitore për Kosovën nëse preket sovraniteti, demokracia dhe integriteti i saj, por nuk do të ishte fitore për të as nëse minoritetet nuk respektohen”, tha Hovenieri.

Ai tha se habitet nga disa “sugjerime të padeklaruara” në Kosovë se ka rrugë tjetër përveç dialogut. “Është një sugjerim se amerikanët, apo gjermanët apo

njerëzit tuaj favoritë, do ta përdorin shkopin magjik dhe të bëjnë bisedat e duhura dhe këto probleme do të zgjidhen dhe Kosova do të jetë menjëherë anëtare me të drejta të plota e NATO-s dhe BE-së. Bota nuk funksionin kështu”, tha ai.

Hovenieri ka theksuar se për ta arritur anëtarësimin e plotë në NATO dhe BE, Kosova duhet ta sigurojë miratimin e të gjitha vendeve anëtare. “Nuk e shoh se si mund të bëhesh anëtar i plotë i NATO-s pa miratimin e të gjithë anëtarëve të NATO-s”, tha ambasadori amerikan. Ai theksoi se disa nga këto vende ende nuk e kanë njohur zyrtarisht realitetin e një Kosove sovraane, të pavarur dhe demokratike, dhe se është e rëndësishme që Kosova t'i bindë ato. “Ju duhet t'i bindni ata. Ne duam të ndihmojmë, por kjo do të thotë të punojmë në procesin e vendosur nga institucionet përkatëse”, shtoi ai. Në një deklaratë të mëtejshme, Hovenieri përmendi një shprehje të gjyshit të tij, duke ilustruar rëndësinë e qasjes së kujdesshme në proceset diplomatike. “Nëse dëshiron të bashkohesh në një klub, mos urino te dera e klubit”. Bashkimi Evropian e ka bërë të qartë se e ardhmja e Kosovës dhe Serbisë varet kryekëput nga zbatimimi i plotë i detyrimeve që ato i kanë marrë në dialogun e Brukselit.

Më 17 shtator në Bruksel, Lajçaki ka takuar ndaras në takime kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi dhe atë të Serbisë,

Petar Petkoviç. Bislimi u takua dy herë me Lajçakun dhe tha se takimi trepalësh me Petkoviçin dështoi pasi Serbia e “kushtëzoi agjendën e takimit me kërkesa të papranueshme për Kosovën”. Ai nuk shpjegoi se çfarë kërkesash shtoi pala serbe për ta kushtëzuar pjesëmarrjen në takim trepalësh. “Në agjendë kishte vetëm një pikë, ecja përpara me zbatimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve. Por u theksua se tema shtesë mund të diskutohen nëse të dyja palët pajtohen. Ne u pajtuam për këtë, por Serbia donte ta kushtëzonte pjesëmarrjen e saj në takim me tema shtesë në agjendë, të cilat nuk ishin të pranueshme për palën e Kosovës”, tha Bislimi.

Në takimin dypalësh me Lajçakun, Bislimi tha se temë kryesore ka qenë rruga përpara për zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të implementimit në Ohër, për të cilat Kosova dhe Serbia u pajtuan më 2023. “Tema kryesore në takim me Lajçakun ka qenë rruga përpara në zbatimin e Marrëveshjes Bazë dhe aneksit të implementimit në Ohër. Kemi folur edhe për atë se deri ku kemi mbërritur me disa marrëveshje të tjera dhe ku kemi hasur në probleme”, shtoi ai.

Për herë të fundit Bislimi dhe Petkoviçiq janë takuar në fillim të korrikut, por pa ndonjë rezultat. Marrëveshja Bazë, e cila përfshin edhe obligimin për themelimin e këtij asociacioni, është arritur në

EPOKA
ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të mërkurën se Shtetet e Bashkuara presin që Kosova dhe Serbia ta marrin seriozisht dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore, pasi ka pasur ngecje në vitin e fundit.

Duke folur në Samitin për Paqe dhe Demokraci në Prishtinë, Hovenieri tha se të dyja palët duhet patjetër t'i zbatojnë të gjitha detyrimet e dala nga ky dialog, i cili nisi më 2011 në Bruksel. “Njohja reciproke mbetet synimi kryesor i Shteteve të Bashkuara sa i përket

normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, kjo është më se e qartë. Ne presim të dyja palët të veprojnë plotësisht në përputhje me të gjitha detyrimet e dala nga dialogu dhe presim që ato ta marrin seriozisht dialogun”, tha Hovenier.

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve në fillim të vitit 2023, por BE-ja ka thënë se ato nuk kanë bërë hapa për ta zbatuar atë.

Hovenieri tha se ajo që nevojitet tani është “serioziteti dhe qëllimi në këtë dialog”. “Mund ta quani rifillim nga e para, mund ta quani ripërkushtim, mund ta quani qasje e re, mund ta quani qasje më energjetike. Ne kemi nevojë për të, dhe kemi nevojë

Sveçla thotë se reformimi i administratës publike është kyç për rrugën e Kosovës drejt BE-së



PRISHTINË, 24 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar që të gjithë të përfshirët në sulmin e armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit një vit më parë të mbahen përgjegjës.

Më 24 shtator të vitit të kaluar, një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë të Zveçanit, duke e vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Gjatë përleshjeve që pasuan u vranë edhe tre sulmues serbë.

Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, bëri homazhe te varri i Bunjakut në Vushtrri më 24 shtator. "Sot iu bashkova Qeverisë së Kosovës dhe kolegëve të mi diplomatikë

për ta nderuar kujtimin e oficerit të Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, i cili u vra në detyrë në sulmin e Banjskës, një vit më parë. Shtetet e Bashkuara përsërisin thirrjet dhe presin që kryerësit dhe të gjithë të përfshirët në këtë krim të tmerrshëm të mbahen përgjegjës", shkroi Hovenier në X.

Ndërkaq BE-ja tha se pret nga Serbia të ndërmarrë hapa të nevojshëm për t'u siguruar që të dyshuarit për kryerjen e sulmit vdekjeprurës në Banjskë të japin llogari.

Kosova e ka cilësuar sulmin si terrorist dhe e akuzon shtetin e Serbisë se ka gisht në të. Serbia i ka mohuar akuzat.

Në fillim të këtij muaji, Prokuroria

Speciale e Kosovës ngriti aktakuzë kundër 45 personave për këtë sulm.

Përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoiqi, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit.

Në aktakuzën e ngritur nga Prokuroria e Kosovës, Radoiqi cilësohet si "kreu i grupit terrorist". I pyetur nga Radio Evropa e Lirë se a duhet Serbia të bashkëpunojë me Kosovën në proceset gjyqësore që do ta pasojnë, Stano tha: "Po, kjo është ajo që ne kemi nënvizuar në mënyrë të vazhdueshme, për ato raste ku kryesit e dyshuar janë në Kosovë". Autoritetet në Serbi refuzojnë ta ekstradojnë Radoiqin në Kosovë

dhe thonë se ai do të gjykohet nga "gjykatat serbe", ndërsa zyrtarët në Kosovë thonë se ato i kanë ofruar mbrojtje atij.

Stano tha, gjithashtu, se Serbia duhet të bëjë më shumë edhe në lidhje me të dyshuarit për sulme ndaj ushtarëve të KFOR-it, ndaj medieve dhe qytetarëve në trazirat e muajit maj të vitit të kaluar. "BE-ja, në mënyrë të përsëritur, ka shprehur pritjet që Serbia duhet të bashkëpunojë plotësisht dhe t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të kapur dhe për t'i sjellë shpejt para drejtësisë kryesit e akteve të dhunës nga ana e protestuesve serbë të Kosovës ndaj qytetarëve, pjesëtarëve të KFOR-it, organeve të rendit dhe mediave, më 29 maj të

vitit 2023. Gjithashtu, edhe për sulmet e dhunshme më 24 shtator 2023 në veri të Kosovës", tha ai.

Qershorin e kaluar gazetarë të medimeve të ndryshme u sulmuan fizikisht teksa po raportonin nga komuna e Leposaviqit, një prej katër komunave në veri, të banuara me shumicë serbe, sipas Policisë së Kosovës.

Tensionet në veri të Kosovës u rritën më 26 maj, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri, me asistimin e Policisë së Kosovës, u vendosën në ndërtesat komunale. Tensionet kulmuan më 29 maj, kur protestuesit serbë u përleshën me pjesëtarët e KFOR-it në Zveçan, me ç'rast u lënduan rreth 100 ushtarë të misionit paqeruajtës.

Haradinaj komenton deklaratën e Hovenierit: Kambanat po bien për të gjithë ata që kanë vesh

Prishtinë, 25 shtator - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj deklaratës së ambasadorit amerikan në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, i cili tha se "mos urinoni nga klubi ku doni të hyni".

Haradinaj në "Facebook" ka thënë se kjo është një shprehje shumë e pazakontë e tij që, sipas tij, është shprehje e dhimbjes dhe pakënaqësisë për kursin dhe rrugën e gabuar

që ka përzgjedhur Kosova. "Ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier ka qenë i kyçur në temën e Kosovës që nga lufta çlirimtare e popullit tonë e posaçërisht gjatë negociatave nën udhëheqjen e Marti Ahtisaarit. Ambasadori Hovenier shquhet si njeri me vlera të larta njerëzore, top diplomat me një urtësi të madhe politike, njerëzore dhe intelektuale. Ai ka gjithmonë fjalë të përzgjedhura dhe ka një dashuri të madhe për Kosovën

dhe popullin e saj. Shprehja e tij 'mos urinoni nga klubi ku doni të hyni' është shprehje shumë e pazakontë e tij. Kjo shprehje e pazakontë është shprehje e dhimbjes dhe pakënaqësisë për kursin dhe rrugën e gabuar që ka përzgjedhur Kosova. Njerëzve që e duan Kosovën si Hovenier kjo ju dhemb. Kosova është keq dhe ka trend të përkeqësimit. Kambanat po bien për të gjithë ata që kanë vesh!", ka shkruar Haradinaj.



shkurt të vitit të kaluar, por nuk ka gjetur zbatim.

Këtyre takimeve u kanë paraprirë udhëtimet e të dërguarit të posaçëm të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, në Prishtinë dhe në Beograd.

Kosova dhe Serbia janë në negociatë për normalizimin e marrëdhënieve qysh në vitin 2011.

Përveç në nivel kryenegociatorësh, bisedimet zhvillohen edhe në nivel politik.

Megjithatë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk janë takuar qysh nga shtatori i vitit të kaluar dhe të dy kanë akuzuar njëri-tjetrin për qasje jokonstruktive.

Lajçaku diskuton me O'Brien dhe Kasanof për dialogun Kosovë - Serbi

Emisari evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav

Lajçak, tha se ka zhvilluar "diskutim strategjik" për dialogun me ndihmësekretarin amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, dhe me emisarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof. "Gjithmonë është e dobishme

të kemi diskutim strategjik për dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe dinamikat rajonale me ndihmësekretarin O'Brien dhe emisarin Kasanof. Mirëpres vazhdimin e bisedës sonë javën e ardhshme në Bruksel", ka shkruar Lajçak në X.

Koalicionet normale dhe jonormale për zgjedhjet e 9 shkurtit



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

Të gjithë fitues, kush do të jetë i dyti: Fushata zgjedhore ka filluar edhe para ditës së shpalljes së zgjedhjeve. Aderime nga një parti në tjetër në bënë në konferenca për media ndonjëse të aderuarit ish-in bateri të zbratura në "partinë nënë" dhe në partinë e re kaluan si skrap, material i pareciklueshëm dhe i dëmshëm për mjedisin. Aleanca e Ramushit mbledhi më së shumti të tillë e që i mbështollën me emra të mëdhenj që në Kosovë ka pak si p.sh. "Forumi i intelektualëve..." dhe limonada të tjera. PDK-ja kryesisht merrej me diasporën, pa rekrutuar ndonjë emër të madh, së paku deri më tani. As LDK-ja nuk pati aderime domethënëse të kësaj bote, vota po kërkon nga varri dhe përmendoret. Nga varri i gjallë që quhet Vojsa Osmani dhe nga votat nga varri i Ibrahim Rugovës. Sikur edhe nga përmendoret e Rugovës që po mbijnë aq kohë sa e kërkon politika apo sa zgjatë nevoja për vota. LV-ja po "dobësohet" shumë me largimin e Vojsa Osmanit, në fakt ajo nuk u largua por u përzë nga Albin Kurti, ekzekutori mizor i të gjithë kundërshtarëve politikë që i ka apo i duken të tillë sipas dioptrisë antikombëtare të Dejana Mihalit, udbashes së LV-së. Në anën tjetër, LV-ja u "forcua" shumë pasi i konfirmuan "besnikërinë", më mirë të them

llaskucërinë Donika Shvarc - Katrani, Faton si Peci, Haxhi Qamili dhe 10 të tjerë që është komplet partia s'GUXO.

Parti tjera që do të garojnë në zgjedhje, të deklaruar deri më sot nuk ka përveç partive të pakicave që pas rezultatit të zgjedhjeve përcaktohen se kujt i mbajnë zhagun.

Realisht, LV-ja konsiderohet parti fituese, vetëm përqindja diskutohet. Sipas "eruditëve" të LV-së, Halil Thaçit, Dimal Bashës, Mef Bajçinovci dhe dinozaurëve injorantë të kësaj partie, pa votat e diasporës kjo parti i fiton mbi 50 për qind kurse, me votat e diasporës i fiton mbi 150 për qind. Thonë se kufijtë e mençurisë janë të dukshëm dhe të matshëm, kurse të budallakisë nuk kanë kufij dhe nuk mund të maten. Për këtë arsye LV-ja nuk ka nevojë për koalicion, e formon qeverinë vet, me pakica dhe shokun e Mimosës, Radojiçiqin. Edhe LDK-ja deklarohet se i fiton zgjedhjet, e formon qeverinë me kryeministër Lumin e Xhikës dhe se nuk bënë koalicion me askënd, pa Lumin kryeministër dhe me ata që ecin "Rrugës së Vjetër" e jo "Rrugës së Re". Mashtrim optik, asgjë tjetër. Edhe PDK-ja del se i fiton zgjedhjet me Bedri Hamzën kryeministër. Gjithashtu nuk pranon asnjë koalicion pa Bedriun kryeministër. Kanë të drejtë ta shfrytëzojnë lirinë e fjalës dhe të shprehjes. Koalicioni AAK-NISMA thotë se do të jenë befasi e zgjedhjeve, se çfarë nuk dihet. Ende nuk kanë kandidat për kryeministër.

Rezultatet reale: LV-ja fiton zgjedhjet, por as në ëndërr 50 për qind. Mund të hidhërohen shumë Halili, Dimali apo edhe trashëgimtari jotrim i trimit Bel Bajçinovci, por baza reale e votuesve të LV-së nuk e kalon 25 për qind. Të gjitha votat mbi këtë përqindje mund të jenë për shkak të opozitës së vdekur klinikisht apo një populizmi patriotik. Realisht, populizmin, LV-në e ka përsosur, ndërsa me patriotizmin nuk kanë asgjë të përbashkët, që nga kreu e deri te fundi. LV-ja e ka argument kryesor veriun e Kosovës, sovranizimin e kësaj pjese dhe për analfabetët funksionalë, karshillëku ndaj ndërkombëtarëve është arma bërthamore e tyre aq më parë që kjo paraqet shpagim për ata që kanë mungesë patriotizmi dhe njohurive politike. Që nga koha e Pirros nuk ka pasur qeveri më të dobët, më të korruptuar, më mashtruese, më rrence, më antikombëtare dhe me mungesë të kompetencës politike dhe diplomatike se kjo e sotme. Përfundim bën Ministria e Arsimit që udhëhiqet nga një ish-analfabete dhe një veteriner aktual. Thashë ish-analfabete për faktin se nga burimet e sigurta kam mësuar se Arbërie Nagavci ka shënuar përparim të madh, i dinë thuaja 70 për qind të shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe, ndërkaq zëvendësministri i kësaj ministrie, veteriner me profesion thonë se i di 30 për qind të shkronjave të alfabetit të gjuhës shqipe e që nënkupton se të dy bashkë i dinë të gjitha shkronjat e alfabetit. Pasi

na llogarisin si kope të deleve, për edukim cilësorë është e domosdoshme që njëri nga drejtuesit e arsimit të jetë veteriner. Largpamës është Albini! LV-ja paturpësisht ka manipuluar me Bacën Adem Demaçi duke i vendosur përmendoren para kafiterive në Podujevë dhe duke e rajonalizuar dhe marginalizuar rolin e Bacës. Në vend se të angazhohet që Baca Adem, së pari ta zë vendin në Prishtinë, e degdisën në Podujevë për qëllime politike dhe partiake. Gjithashtu, kryeministri Kurti kishte ndarë tinëz nga publiku mbi 50 mijë euro për përmendoren e Rugovës në Podujevë e që është vendosur në vendin më të mirë të qytetit. PDK-ja po gabon që përmes urbanizimit politik disi po distancohet e të qenit parti e dalë nga lufta e që objektivisht edhe është. LDK-ja nuk ka bërë asnjë reformë përveç se po investon materialisht në varrin dhe përmendoret e Rugovës, ndërsa partinë e ka bërë klientelë të kryetarit që i ka larguar thuaja të gjithë themeluesit dhe kontribuuesit e partisë duke i zëvendësuar me servilë permanent, mbijetues të të gjitha regjimeve dhe kohërave. Fetishizimi i Rugovës bëhet për përfitime politike dhe karrieriste, jo shkak i respektit. AAK-ja ka votues të qëndrueshëm që i sigurojnë të mos marrin në thua të pragut zgjedhor.

Koalicionet: Nëse nuk ka zhvillime të paparashikuara, jam i sigurt se

partitë opozitare mund ta fitojnë shumicën parlamentare shqiptare por se kjo nuk garanton se mund ta bëjnë qeverinë, jo shkak i votave, por shkak i postit të kryeministrit. PDK-ja dhe LDK-ja nuk e lëshojnë këtë post, kurse AAK-ja mund të rrisë pazarin sepse është përcaktuese për numrat që mundësojnë formimin e qeverisë. AAK-ja mund të ketë pozicion të fortë negociues edhe me LV-në. Mendoj se AAK-ja e ka pozicionin më të fortë negociues në sandviçin midis LV-së, në njërin anë dhe LDK-së e PDK-së, në anën tjetër.

Po flitet për një koalicion midis LV-së dhe PDK-së për të cilin besoj se humbëse absolute do të ishte PDK-ja. Pariparueshëm humbëse. Do të përçahet partia dhe do të pengohet reforma. Do të përligjej qëndrimi kriminal i LV-së ndaj udhëheqësve të luftës dhe PDK-së që janë të burgosur në Hagë, me një kontribut domethënës të partisë në pushtet. Politikisht do të ishte fat i Titanikut për LDK-në dhe PDK-në nëse bëjnë koalicion me LV-në. Partitë opozitare duhet të mbesin në opozitë për të fituar në zgjedhjet e radhës. Koalicioni i LV-së me njërin parti të madhe opozitare e rehabiliton nga të gjitha të këqijta që i ka bërë kjo parti, në emër të luftës ndaj të këqijave të mëparshme. LV-ja ose duhet të kalojë në opozitë ose duhet lënë që t'i kryejë të gjitha detyrat që i ka marrë nga ndërkombëtarët e që janë rrënuese për këtë parti, e deklaruar kombëtare dhe socialdemokrate, ndërsa në fakt është antikombëtare dhe nacionalsocialiste.

Votat LV-ja: 30-35 për qind, kurse LDK-ja dhe PDK-ja jo nën 21 - 22 për qind. AAK - NISMA do të sillt midis 8.5 - 9.5 për qind. Kjo përqindje varet nga lista e propozuar për deputetë, nëse riciklohen kuadrot e vjetra partiake, të parapaguara për poste dhe pushtet, përqindja ulet. Si shembull e marr PDK-në. Nëse nuk e vendosë në 10 e parë Përparim Grudën, nënkupton se nuk respekton dhe vlerëson vlerat që e bënë diferencën në fushën e drejtësisë dhe demokracisë. Kjo vlen edhe për LDK-në. Por, me një siguri mbi 90 për qind e them se listat do të jenë riciklim i zgjedhjeve paraprake. Këtu LV-ja krijon epërsi. Të rrojmë, të mbijetojmë deri në atë kohë e të shohim!

Haxhiu nënshkruan kontratën për renovimin e objektit të IML-së, vlera rreth 815 mijë euro

Prishtinë, 25 shtator - Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka nënshkruar kontratën për renovimin e objektit të Institutit të Mjekësisë Ligjore, me vlerë 814,229.72 euro. Ajo ka thënë se ky

investim po bëhet për herë të parë dhe do ta mundësojë transformimin e plotë të hapësirës së brendshme, duke përfshirë renovimin e laboratorëve, sallave të autopsisë, kulmit dhe zyrave të punës.

"Përmes këtij projekti po ndërtojmë një institut që jo vetëm përmbush standardet më të larta teknike dhe funksionale, por edhe rrit sigurinë dhe efikasitetin e shërbimeve për qytetarët. Ky është një

hap konkret drejt përmirësimit të infrastrukturës mjekoligjore, duke garantuar shërbime moderne dhe cilësore në të gjitha rastet", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



Britania dërgon personel dhe automjete në Kosovë për stërvitje me KFOR-in

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Britania e Madhe ka dërguar personel dhe automjete në Kosovë për ato që misioni paqeruajtës i Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR, thotë se janë ushtrime rutinore. Në një njoftim për medie, KFOR-i tha se personeli dhe automjetet nga Regjimenti Mbretëror i Jorkshërit kanë mbërritur të mërkurën në Durrës, Shqipëri, dhe do të zhvendosen në Kosovë përmes rrugës tokësore. Ai nuk tregoi se sa pjesëtarë të personelit apo automjete janë dërguar. "Siç është thënë më herët, Regjimenti Mbretëror i Jorkshërit do të kryejë një sërë aktiviteteve stërvitore, së bashku me trupat e tjera të KFOR-it deri në fund të tetorit", thuhet në njoftim. Më herët këtë muaj, Britania i

dërgoi më shumë se 300 trupa në Kosovë për këto ushtrime rutinore. KFOR-i theksoi se "qëllim i stërvitjeve është testimi i procedurave ekzistuese për dislokimin e shpejtë të trupave shtesë dhe integrimin e tyre në kuadër të misionit". Kontingjenti britanik do të kthehet në Britani të Madhe sapo të përfundojnë ushtrimet në tetor, tha misioni paqeruajtës. Zhvendosja në Kosovë i personelit dhe automjeteve të ushtrisë britanike për stërvitje u bë disa javë pasi KFOR-i zhvilloi atë që e quajti trajnim mbi urën e Ibrit, e cila ndan Mitrovicën në jugun e banuar me shqiptarë dhe veriun e banuar me serbë. Mbi këtë urë, që Kosova po synon ta hapë për qarkullim të automjeteve, KFOR-i ka prani të



përhershme. Bashkësia ndërkombëtare u ka kërkuar autoriteteve në Kosovë

që të përmbahen nga një veprim të tillë tani për tani, ndërkajmisioni i NATO-s dhe Bashkimi

Evropian kanë kërkuar që çështja e urës të zgjidhet përmes dialogut.

Haradinaj me partnerët e koalicionit paraqesin programin zgjedhor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Koalicioni AAK, Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore dhe Forumi Intelktual E-30 kanë paraqitur të mërkurën programin zgjedhor 2025-2029. Katër partnerët e koalicionit paraqitën programin e përbashkët, i cili prek çdo sferë të jetës qytetare dhe forcon themelet e shtetit tonë.

Kryetari i AAK-së, njëherësh kandidat për kryeministër, Ramush Haradinaj, ka thënë se ky program është rezultat i një pune dyvjeçare që përfshin katër shtylla kryesore, e siç janë anëtarësimi urgjent i Kosovës në NATO, zhvillimi i hovshëm ekonomik, përmbyllja e dialogut me Serbinë me njohje reciproke dhe integrim në BE dhe me konceptin Kosova



shtet i jetueshëm e jo i braktisur. "Ky program është rezultat i mbi 20 tryezave tematike-sektoriale, dhjetëra takimeve e konsultimeve të organizuara nga Aleanca dhe partnerët e saj. Në këtë program kanë marrë pjesë qindra ekspertë të profileve e fushave të ndryshme, të ekonomisë e financave, arsimit

e shëndetësisë, çështjeve sociale e kategorive të lirisë, sigurisë, politikës së jashtme e diplomacisë, energjisë, kulturës, ambientit, rinisë", u shpreh Haradinaj, duke shtuar se ky program ka moton "Për një Kosovë ndryshe". Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka

thënë se ky program jep shpresë dhe mundësi, me ç'rast ka përmendur edhe objektivat e koalicionit. "Nisma Socialdemokrate në veçanti fokus do të ketë: Reformën fiskale, përmes së cilës synohet fuqizimi dhe rritja e bizneseve të vogla dhe të mesme. Kthimi i Partneritetit Publiko-Privat, si koncept i cili ka rezultuar me sukses në vendin tonë. Paketa Sociale përmes reformës e cila do t'u mundësojë familjeve me kushte të vështira ta përfjetojnë dorën e shtetit. Ringritja e kapaciteteve energjetike përmes ndërtimit të termocentraleve dhe shfrytëzimit të resurseve dhe mineraleve tona. Investimi në bujqësi përmes ngritjes së fondeve në stimulime dhe grante ndaj punëtorëve me qëllim harmonizimin e jetesës urbane dhe rurale. Reforma në

drejtësi përmes matjes së performancës dhe jo ndërhyrjes në të. Këto dhe pika të tjera do të vazhdojmë t'i elaborojmë në vazhdimësi, duke qenë falënderues ndaj grupit të ekspertëve dhe gjithë atyre që kanë punuar në ndërtimin e këtij programi të detajuar", ka thënë Limaj. Kryetari i Forumit Intelktual E-30, Artan Nimani, ka thënë se ky koalicion është një përkushtim i palëkundur për ta ndaluar degradimin e skajshëm diplomatik, ekonomik dhe social të vendit. Abdullah Klinaku, kryetar i Listës Konservatore, ka thënë se në këtë program qeverisë familja ka qenë, po ashtu, një nga prioritetet e programit, me ç'rast edhe i ka bërë të ditura propozimet në kuadër të kësaj çështje.

Komisioni për Legjislacion miratoi Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Me ftesë të Komisionit për Legjislacion, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka paraqitur para anëtarëve të Komisionit ndryshimet e adresuara të Projektligjit për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme, tani pas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në fjalën e saj, ministrja Haxhiu tha se Projektligji për Byronë është pjesë e përpjekjeve të qeverisë dhe Ministrisë së Drejtësisë për zhvillimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, duke përfshirë luftën kundër krimit dhe

korruptionit, dy fenomene që vazhdojnë të përbëjnë sfida për vendin tonë. "Një nga sukseset më të rëndësishme ishte konfirmimi i konceptit të konfiskimit civil si një instrument legjitim dhe proporcional për luftën kundër korruptionit në sektorin publik, një arritje e madhe për shtetin e së drejtës", tha ministrja Haxhiu. Më tutje, Haxhiu tregoi për adresimin e çështjeve të Projektligjit pas shpalljes së aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese duke përmendur këtu nenet kyçe si: adresimi i retroaktivitetit të ligjit, qartësia e

periudhave kohore për verifikimin e pasurisë, ndryshimin e përbërjes së komisionit mbikëqyrës dhe ndarjen e pushteteve. Në fund ministrja Haxhiu tha se qeveria nuk ka përpiluar një projektligj të ri, por vetëm janë adresuar në mënyrë specifike çështjet që Gjykata Kushtetuese i konsideroi në kundërshtim me Kushtetutën. Pas diskutimeve në Komisionin për Legjislacion, anëtarët me 6 vota për kanë miratuar Projektligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme.



CEFTA, ministri gjerman: Po përpiqemi të gjejmë një zgjidhje për Kosovën

PRISHTINË, 25 SHTATOR - CEFTA, ose marrëveshja e re për tregti të lirë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, ishte një nga temat kryesore të ministerialit të ekonomisë, të martën, 24.09.2024 në Berlin.

Robert Habeck, ministri i Ekonomisë së Gjermanisë dhe organizatori i takimit, shprehu shpresën se do të gjendet një zgjidhje për përfshirjen e Kosovës në këtë marrëveshje. "Sot u fol shumë me Serbinë dhe Kosovën, pasi CEFTA varet nga to. Po përpiqemi të gjejmë një kompromis që ta mundësojë përmbylljen e marrëveshjes. Rajoni është shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet të mbetet i varur nga konflikte rajonale", tha Habeck pas ministerialit të ekonomisë, të martën (24.09.2024) në Berlin. "Sado i komplikuar të jetë konflikti, është e rëndësishme të tregojmë fleksibilitet për të ecur përpara, përndryshe do të duhet të gjenden zgjidhje alternative", tha ai.

Procesi i Berlinit, me apo pa Kosovën?

Takimi në Berlin kishte për qëllim përgatitjen e Samitit të Procesit të Berlinit, që do të mbahet më 14 dhe 15 tetor, në drejtimin e kancelarit gjerman Olaf Scholz e ku synohet të nënshkruhet marrëveshja e tregtisë së lirë. Aktualisht, tregtia e lirë realizohet përmes CEFTA-s, por Kosova e ka refuzuar këtë rrugë në të kaluarën, pasi përfaqësohej nga UNMIK-u dhe jo si shtet i pavarur. Qëllimi i samitit është përfshirja e Kosovës si shtet i pavarur në një marrëveshje të ngjashme me CEFTA-n, gjë që mund të realizohet vetëm në kuadër të Procesit të Berlinit, ku Kosova tradicionalisht përfaqësohet si shtet dhe me të gjitha simbolet shtetërore.

Kushti për Kosovën është heqja e bllokadës aktuale ndaj produkteve serbe, e cila është shkelje e parimeve të CEFTA-s. Manuel Sarrazin, i ngarkuari i qeverisë gjermane për Ballkanin



Perëndimor, kishte paralajmëruar në fillim të shtatorit se, nëse Kosova nuk ndërmerri këtë hap, ajo mund të përjashtohet nga Procesi i Berlinit.

I pyetur nga DW se a do të ketë një marrëveshje edhe pa Kosovën, Habeck nuk u përgjigj drejtpërdrejt. "Është thelbësore të mbahen bashkë shtetet e Ballkanit Perëndimor, dhe Kosova është në qendër. Interesi i përbashkët është zhvillimi i një rajoni të integruar, dhe për këtë po punojmë tani", tha ai.

Taksë doganore për produktet me energji fosile

Ministeriali i ekonomisë u zhvillua me moton "Dhjetë vitet e Procesit

të Berlinit - Ballkani Perëndimor si zonë ekonomike në rrugën drejt Bashkimit Evropian". Një nga temat e tij, përveç marrëveshjes së tregtisë së lirë ishte energjia e ripërtërishme.

Habeck theksoi rëndësinë që produktet që hyjnë në BE të jenë të prodhuara me energji të gjelbër dhe njoftoi se për mallrat e prodhuara me energji fosile do të vendoset një taksë doganore.

Bashkëpunimi rajonal me rëndësi të madhe

Një tjetër çështje kyçe për zhvillimin ekonomik të rajonit është bashkëpunimi rajonal.

Habeck theksoi se Ballkani Perëndimor ka fituar vëmendje si

vend investimesh për shkak të afërsisë me Evropën, ndërsa vendet e tjera që ndodhen në luftë kanë humbur interesimin e investitorëve. Ai vuri në dukje se tregu i përbashkët rajonal, i cili po përpqet të krijohet në Ballkanin Perëndimor, është kyç për tërheqjen e investimeve. "Vendet e Ballkanit më vete janë shumë të vogla për të tërhequr shumë investitorë. Prandaj vetëm krijimi i një hapësire të përbashkët e pa barriera do të sjellë investitorët në rajon", tha Habeck.

Para takimit ministror, në Berlin u mbajt një forum biznesi, ku morën pjesë rreth 250 përfaqësues nga biznesi gjerman dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Ekonomia gjermane ka një interes të madh

për zhvillimin ekonomik të rajonit. Në dekadën e fundit ajo ka hapur mbi 130 000 vende pune të kualifikuara. Tregtia ndërmjet Gjermanisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor është trefishuar dhe në periudhën janar-korrik 2024, volumi tregtar arriti në 10.7 miliardë euro, me një rritje prej 2 % krahasuar me vitin e kaluar.

Procesi i Berlinit është një iniciativë e qeverisë gjermane nga viti 2014 dhe një platformë e përbashkët për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, Komisionin Evropian, disa vende të BE-së dhe Britaninë e Madhe që synon ta mbështesë afrimin e vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian. /DW/

Guvernatori i BQK-së thotë se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 3.3-përqindësh

Prishtinë, 25 shtator - Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere, kryesuar nga kryetari Armend Muja, mbajti të mërkurën mbledhjen e radhës në të cilën u votuan disa raporte financiare për vitin 2023, shqyrtimi i të cilave ishte bërë në mbledhjet e kaluara.

Kështu Komisioni votoi raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës, raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit, raportin vjetor financiar të Këshillit Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, raportin vjetor financiar të Agjencisë për Informim dhe Privatësi dhe raportin vjetor financiar të Këshillit të Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbim Civil. Komisioni, po ashtu, me shumicë votash miratoi raportin e punës së Komisionit për sesionin pranveror për vitin 2024 dhe draft-planin e punës së Komisionit për sesionin vjeshtor për vitin 2024. Në këtë mbledhje Komisioni nuk e miratoi raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Shërbimit të Ujit, ndërsa shqyrtimi i propozimeve të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe formimi i grupit punues për Projektligjin për Bankat u shtynë për mbledhjen e radhës.

Mbledhja vijoi me shqyrtimin e raportit vjetor të punës së Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2023, të cilin e paraqiti guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili.

Guvernatori Ismaili tha se ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 3.3-përqindësh, ndërsa shtoi se një përqindje e madhe e inflacionit është importuar.

Pas prezantimit, anëtarët e Komisionit shtruan shumë pyetje lidhur me raportin, të cilave iu përgjigj guvernatori BQK-së. Pas përfundimit të debatit, raporti vjetor i punës i BQK-së u la që të votohet në mbledhjen e radhës.

Augusti i Fort - A është ky mbreti më i keqkuptuar në histori?

Recension mbi librin e historianit Tim Blanning – *Augusti i Fort: Një studim mbi madhësinë artistike dhe fiaskon politike [Augustus The Strong: A Study in Artistic Greatness and Political Fiasco]*.



Nga: Noel MALCOLM
The Daily Telegraph
Përkthimi: Agron SHALA
Telegrafi.com

Për aq sa mbaj mend, ka pasur historianë me mendësi puritane që kanë thënë se nuk duhet të shkruajmë më për mbretërit dhe mbretëreshat. Në të kaluarën na këshillonin të shkruanim për lëvizjet shoqërore dhe faktorët ekonomikë; tani temat kryesore janë gjinia, raca dhe mjedisi. Të gjitha këto meritojnë të studiohen, por është absurde të mendojmë se duhet të injorojmë sundimtarët e shekujve të kaluar.

Mbretërit dhe mbretëreshat kanë rëndësi sepse deri vonë ishin ata që shtynin gjërat përpara. Ne mund ta mbivlerësojmë fuqinë e tyre, siç shpeshherë bënin edhe ata vetë. Por, në shumicën e shteteve evropiane, nga Mesjeta e deri në fillim të shekullit XIX, vullneti mbretëror ishte faktori më i madh i vetëm që ndikonte në qeverisje, diplomaci dhe zhvillimin e luftërave. Në fakt, deri në mesin e shekullit XIX, ishte ende normale që mbretërit të udhëhiqnin vetë trupat e tyre në betejë.

Augusti i Fort, sundimtari i Saksonisë dhe Mbreti i Polonisë (1670–1733), dukej se kishte atributet për një rol të tillë udhëheqës. Nofka e tij i referohej aftësisë së tij për të thyer patkonjtë vetëm me duar; ai ishte shenjtar i shkëlqyer

dhe deri në moshën 23-vjeçare kishte marrë pjesë në pesë fushata ushtarake. Kur vitin e ardhshëm pasoi vëllain e tij si sundimtar i Saksonisë, ai dukej si personi i përsosur për këtë rol: një karakter i fuqishëm, më i madh sesa jeta (oreksi i tij për pije dhe gra ishte sigurisht më i madh se i shumicës), por gjithashtu një dashamirës i artit dhe një promovues i vërtetë i industrisë dhe tregtisë.

Çfarë mund të shkonte keq?

Përgjigja, siç shpjegon biografia e re e Tim Blanningut, është kjo: pothuajse gjithçka. Gabimi i parë i Augustit ishte gjithashtu më i madhi dhe krijoi kushtet për gjithçka që shkoi keq më pas. Kur Mbreti i Polonisë, John Sobieski (i famshëm për shpëtimin e Vjenës kur u rrethua nga osmanët më 1683) vdiq papritur më 1696, Augusti ndërmoi një fushatë politike për t'u bërë pasardhës i tij; pasi pagoi një mori rryshfetesh të shtrenjta dhe pasi u konvertua në katolicizëm – për shkak të oportunitetit flagrant – më në fund u zgjodh për fronin polak. Kjo ia dha atij titullin e duhur mbretëror dhe fuqinë nominale mbi vendin më të madh në Evropë, pas Rusisë. Por, fraza “kupë e helmuar” nuk do ta përshkruajë çmimin që ai kishte fituar.

Polonia ishte shteti më i paqeverisshëm në Evropë. Pushteti i vërtetë nuk i përkiste mbretit, por fisnikërisë dhe

qytetarëve të pasur, të cilët formonin një lloj oligarkie masive. Megjithatë, vetë ata kishin pak fuqi për t'i shtyrë gjërat përpara; forca e tyre e madhe qëndronte në aftësinë e tyre për t'i ndaluar gjërat që të ndodhnin, duke përdorur një “veto të lirë” e cila zbatohet lirshëm për çdo masë reformuese ose centralizuese. Si rezultat, ushtria e tyre ishte e dobët për një vend të madhësisë së tillë dhe i gjithë buxheti i shtetit ishte më pak se tre për qind e buxhetit të Francës së Luigjit XIV.

Kjo mund të mos kishte rëndësi nëse sundimtarët e shteteve fqinje do të kishin qenë gjakftohtë dhe dashamirës. Por, mbretërimi polak i Augustit përkoj me ngritjen në madhësi të dy figurave kokëforta dhe agresive: Pjetri i Madh i Rusisë dhe Karli XII i Suedisë. Fatkeqësisht, Augusti pranoi t'i bashkohej të parit në përpjekjen për të copëtuar territoret baltike të këtij të fundit. Ushtria suedeze doli të ishte makinë vrasëse e llojit të vet dhe Karli XII e ndoqi Augustin në një hakmarrje të tërbuar, duke e dëbuar përfundimisht nga Polonia dhe duke vendosur sundimtarin e tij marionetë në fron.

Në mënyrë të pashmangshme, në disa pjesë të librit vëmendje më e madhe bie mbi ata dy monarkë dinamikë sesa mbi heroin tonë të prirur ndaj aksidenteve. Karli shfaqet si maniak gjakftohtë, i cili e kaloi gjithë mbretërimin e tij duke

bërë luftëra, sepse kjo ishte ajo që i pëlqente. Si taktik i shkëlqyer dhe strateg i keq, ai përfundimisht e udhëhoqi gjithë ushtrinë drejt shkatërrimit në Ukrainë dhe iu desh të kalonte pesë vitet e ardhshme si mërgimtar në territorin osman.

Pjetri, ndërkohë, po merrej në mënyrë metodike me rajonin lindor të Baltikut; zotimi për t'ia dhënë një pjesë të madhe të tij aleatit të dikurshëm August (tani i kthyer në Varshavë), siç e thotë bukur Blanningu, “u preh në varrezat e mëdha të premtimeve të tij të thyera”. Historianët polakë nuk i kanë dhënë Augustit një vlerësim të mirë. Gjykimet e tij të gabuara në luftë dhe diplomaci çuan vërtet në vdekje dhe shkatërrim të shkallës së gjerë. Ndjesitë moderne mund të fyhen gjithashtu nga filanderizmi i tij i vazhdueshëm, megjithëse Blanningu e zvogëlon numrin e fëmijëve kopilë nga 354 – që përfliten – në vetëm tetë. Edhe më fyes mbase është përkushtimi i tij ndaj sporteve absurde mizore, të cilat përfshinin hedhjen në ajër me batanije të dhelprave, vjedullave dhe kastorëve derisa të ngordhnin – ai ishte, na thuhet, “një hedhës i mirë”.

Megjithatë, siç thekson edhe Blanningu, Saksonia nën Augustin shënoi një epokë të artë kulturore, falë patronazhit të tij bujar, sensit të shkëlqyer artistik dhe energjisë së papërmbyajtshme. Lulëzuan muzikantët dhe piktorët; ata që

punonin stolitë dhe argjendarët mezi mbulonin kërkesat e tij; Majseni nisi prodhimin e porcelanit elegant dhe kryeqyteti i tij, Drezdeni, u shndërrua gradualisht në një nga qytetet më të bukura në Evropë.

Pjesa më e madhe e kësaj ishte për kënaqësinë personale të Augustit; por, larg nga tërheqja në botën e mbyllur të kulturës elitare të oborrit, ai mirëpriti turmat dhe mbajti festa të mëdha për kënaqësinë e tyre. Dëshira e tij për të përmirësuar gjithë vendin ishte e vërtetë dhe shtrihej deri te ftesa për tregtarët hebrej dhe te këmbëngulja – përkundër disa kundërshtimeve – që ata të lejoheshin të mbanin shërbimet e tyre fetare.

Rrëfimi i Blanningut bazohet në kërkime të gjera në literaturën përkatëse në gjermanisht, polonisht, suedisht dhe rusisht – një paraqitje mbresëlënëse në kulturën tonë akademike gjithnjë e më dëshpëruese të bazuar në një gjuhë. Debatet e studiuesve kryesisht shmangen dhe shkrimi mbetet i freskët dhe tërheqës gjatë gjithë kohës. Nuk jam plotësisht dakord me përshkrimin e Penguin-it [shtëpisë botuese], që e cilëson si biografi “të trazuar”: kjo duket se minimizon argumentet serioze që kalojnë nëpër këtë libër të strukturuar me kujdes. Por, “e kënaqshme” do të ishte më e saktë. Kishte mjaft faqe këtu ku unë u ndjeva vërtet mirë dhe i kënaqur. //Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Takim i rëndësishëm për Lojërat Mesdhetare 'Prishtina 2030' në Athinë



"Epoka e re"

PRISHTINË, 25 SHTATOR - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, të kryesuar nga presidenti Ismet Krasniqi, së bashku me përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në krye me zëvendësministren Daulina Osmani dhe kryetarin e komunës së Prishtinës, Përparim Rama, zhvilluan takim me rëndësi të veçantë me përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare (ICMG), presidentin Davide Pizzano, sekretarin e përgjithshëm Iakovos Filippousis dhe kryetarin e Komisionit Ligjor, Francesco Purromuto. Në takimin e mbajtur në Athinë të Greqisë u diskutua për përparimin e themelimit të komitetit organizativ dhe çështjet përgatitore për Lojërat

Mesdhetare "Prishtina 2030". Takimi dëshmoi një unitet të jashtëzakonshëm të hisedarëve kyçë dhe konfirmoi se jemi në rrugën e duhur për të organizuar një ngjarje madhështore siç janë Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030". "Palët u pajtuan që me kapacitetet dhe aftësitë tona, si dhe me bashkëpunimin ndërinstucional, të vlerësuara lart nga ICMG, jemi të gatshëm të vazhdojmë realizimin e qëllimeve tona të përbashkëta, të krijojmë një trashëgimi të jashtëzakonshme për brezat e ardhshëm dhe duke shndërruar në realitet ëndrrën e komunitetit sportiv dhe çdo qytetari të Republikës së Kosovës! Si produkt i këtij takimi të frytshëm u identifikuan detyrimet që duhet t'i realizojnë palët brenda afateve të caktuara. Pas kësaj do ta presim delegacionin e ICMG në Prishtinë për t'i definuar hapat e

planifikimit infrastrukturor dhe operacional. Takimi dëshmoi se institucionet tona janë të motivuara dhe të përkushtuara që së bashku ta realizojmë projektin më të madh në historinë e sportit të Kosovës", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Ndërsa zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani, ka thënë se Kosova po rrugëton me hapa të sigurt drejt organizimit të ngjarjes më të madhe multisportive në vend. "Në qytetin e lindjes së Lojërave Olimpikë, në Athinë, së bashku me Komitetin Olimpik të Kosovës dhe komunën e Prishtinës u takuam me përfaqësuesit e lartë të Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare për koordinim rreth përgatitjeve për Lojërat Mesdhetare 2030. Kosova po rrugëton me hapa të sigurt drejt organizimit të ngjarjes më të madhe multisportive në vend", ka thënë Osmani.

SHKURT

KB Peja pëson në ndeshjen e parë në Greqi

KB Peja është mundur në ndeshjen e parë kualifikuese për FIBA Europe Cup nga skuadra e Maroussit me rezultat 98:75 (34:20, 20:23, 20:15, 24:17). Ndeshja e dytë do të zhvillohet të enjten, sërish në Greqi, ku do të vendoset skuadra, që do të jetë pjesë e grupeve të kësaj gare për edicionin e ardhshëm. Te Peja dy më të dalluarit ishin Darnell Cowart me 21 pikë e pesë kërcime dhe Jawaun Daniels me 17 pikë e katër kërcime.

Ndeshja Shqipëri - Çeki, ja çmimi i biletave

Nis shitja "online" e biletave për ndeshjen Shqipëri - Çeki, në Ligën e Kombeve, e cila do të zhvillohet në stadiumin "Air Albania" më 16 nëntor. Çmimet e biletave variojnë nga 500 lekë të rinj në tribunat mbi flamurin e këndit, deri në 25 000. Çmimi i biletave në sektorët pas porte janë 1 500 lekë, ndërsa në pjesën balllore kushtojnë nga 2 500 lekë deri në 10 000 në pjesën qendrore. Shqipëria më 11 tetor luan në transfertë me Çekinë dhe më 14 tetor me Gjeorgjinë, po në transfertë, për ta mbyllur fushatën eliminatorë të Grupit 1 në Ligën B me Çekinë (16 nëntor) dhe Ukrainën (19 nëntor) në Tiranë.

Mitaj: I lumtur për debutimin dhe fitoren

Mario Mitaj, mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, debutoi me Al Ittihadin në ndeshjen e Kupës ndaj Al Ain. Ai luajti 71 minuta, duke ndihmuar ekipin në fitoren e pastër 3-0. Mitaj, nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale, është shprehur i lumtur për debutimin. "I lumtur për debutimin dhe fitoren", ka shkruar Mitaj. Vëmendja tani është në kampionat, aty ku ekipi i Laurent Blanc pret Al Khaleej.

Fetahu nderon veteranët e basketbollit

Kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu, në një koktej rasti ka pritur dhe nderuar veteranët e Kosovës. Ai është shprehur falënderues ndaj tyre për kontributin me dekada në basketbollin e Kosovës. Fetahu potencoi se do ta përkrahin Ligën e Veteranëve edhe më shumë, derisa i falënderoi për pjesëmarrjen e tyre në turne të ndryshme në rajon. Ndërkohë, veteranët ishin të lumtur për këtë takim, duke u shprehur të gatshëm për edicionin e ri. Kryetari i FBK-së, po ashtu, ka ndarë trofeun e Kupës për edicionin e kaluar dhe medaljet për kampionin Prishtinën dhe vendin e dytë, Pejën. Fetahu ka nderuar edhe Naim Hajrizin për turneun e fituar në Zará të Kroacisë, si dhe Arsim Svirçën, për kontributin e tij në

Zhegrova në mesin e më të vlerësuarve në Evropë

Lille, 25 shtator - Sulmuesi nga Kosova i Lilles, Edon Zhegrova, e ka gjetur vetëm në mesin e dhjetë futbollistëve më të vlerësuar në top pesë ligat evropiane deri tani në këtë edicion. Zhegrova është njeriu i momentit të klubi i Lilles, duke shënuar gjashtë gola në tetë ndeshje në të gjitha garat. Paraqitjet e tij të mira nuk kanë

mbetur pa u vëre nga faqja e specializuar e statistikave "Sofascore", e cila e vlerëson lart Zhegrovën. Sipas "Sofascore", Zhegrova është lojtari i nëntë me notën më të lartë deri tani këtë sezon, pasi ka një mesatare të notës prej 8.10. Lojtari më notën mesatare më të lartë është ylli i Bayer Leverkusen, Florian Wirtz (8.65), i pasuar nga

Harry Kane (8.50) dhe Erling Haaland (8.42). Në pozitën e katërt renditet Raphinha me mesatare 8.33, ndërsa pas tij vjen Lamine Yamal (8.32) dhe Achraf Hakimi (8.22). Pozita e shtatë është e rezervuar nga Kevin de Bruyne me notë 8.20, e teta nga Vincenzo Grifo me notë 8.18 dhe pozita e dhjetë nga Mohamed Salah (8.04).



Ter Stegeni për përkrahjen pas lëndimit: Ndihej pozitiv dhe i fortë

Barcelonë, 25 shtator - Barcelona është tronditur nga lajmet se Marc-Andre Ter Stegen mund ta humbasë pjesën e mbetur të sezonit, pasi pësoi një dëmtim të rëndë në gju gjatë fitores të së dielës ndaj Villarrealit në "La Ceramica". Kjo do të thotë se katalunasit do të

mbeten pa kapitenin dhe portierin e parë deri në sezonin e ardhshëm, gjë që është një goditje e madhe. Pas dëmtimit, Barcelona tashmë po punon për nënshkrimin e një zëvendësuesi që do të konkurronte me Inaki Pena, i cili do të trashëgojë vendin e titullarit për pjesën e

mbetur të sezonit. Ndërsa kjo është duke vazhduar, Ter Stegen ka folur për herë të parë që nga pësimi i lëndimit. Ai falënderoi të gjithë për mbështetjen e tyre, dhe kjo përfshinte veçmas ata që ishin të pranishëm në stadiumin "La Ceramica". "Ndihej vërtet mirënjohës për

të gjithë tifozët e Barçës, shokët e skuadrës, rivalët, klubet dhe miqtë për mbështetjen dhe dashurinë që më keni treguar që nga e diela. Dua t'i falënderoj tifozët e Villarrealit për respektin e treguar në stadium. Kjo do të thotë shumë për mua. Ndihej pozitiv dhe i fortë. Tani



fokusohej në rikuperimin tim. Faleminderit!", ka shkruar Ter Stegen.

Tri projekte madhore për Shtime afër përfundimit

SHTIME, 24 SHTATOR - Stadiumi i qytetit, Shtëpia e Përshtirshme dhe Palestra Sportive, janë këto tri nga projektet madhore për qytetarët e komunës së Shtimes, në të cilat aktualisht edhe po zhvillohen punimet. Për të parë nga afër këto punime, Hajrulla Çeku, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, së bashku me kryetarin e komunës së Shtimes, Qemajl Aliu, i vizituan këto projekte të cilat do t'i japin dimension kulturor dhe sportiv krejtësisht të ri Shtimes. Me këtë rast, ministri Çeku ka thënë se po punohet me vendosmëri për konsolidim të infrastrukturës sportive në gjithë vendin. "2.4 milionë euro janë paraparë vetëm që ky stadium të jetë i nivelit profesional. Ky projekt synon modernizimin e infrastrukturës së futbollit në këtë qytet", ka thënë Çeku. Ndërsa kryetari Aliu ka deklaruar se stadiumi i qytetit po merr formën e



tij përfundimtare dhe së shpejti do të jetë shtëpia e re e sportistëve e sportdashësve tanë. Shtëpia e Përshtirshme është hapësira që do të shërbejë për aktivitete rinore që do t'i japin energji e gjallëri të paparë Shtimes, ndërsa Palestra Sportive do të ofrojë mundësi të reja për zhvillimin e aktiviteteve

sportive dhe fizike për të gjitha grupmoshat në komunën tonë. "Me punë të palodhur e përkushtim maksimal ndaj cilësisë, po përmblushim çdo premtim e po i realizojmë të gjitha punët e mira në shërbim të qytetarëve tanë siç ishim zotuar para tyre", ka thënë kryetari Aliu.

Varane pensionohet nga futbollli

PARIS, 25 SHTATOR - Raphael Varane ka njoftuar për pensionimin nga futbollli. Ish-futbollisti i Real Madridit dhe Manchester Unitedit vendosi të tërhiqet nga futbollli para kohe. Ish-përfaqësuesi francez aktualisht është 31-vjeçar, shkruan "BBC". Ai iu bashkua ekipit italian Como si transfer i lirë në korrik të këtij viti, por e pësoi një lëndim në gju në debutimin e tij kundër Sampdorias muajin e kaluar. Qendërmbrojtësi thotë se do të qëndrojë në klub, por në një rol tjetër. "Unë e mbaj veten në nivelet më të larta. Dua të largohem i fortë", ka shkruar futbollisti francez në rrjetin social "Instagram". "Të nevojitet një dozë e madhe e kurajës për ta dëgjuar zemrën tënde dhe instinktin", ka shtuar ai. Varane e nisi karrierën në ekipin francez Lens, por e kaloi vetëm një sezon aty para se t'i bashkohej Real Madridit në vitin 2011. Aty i shijoi 10 vjet të karrierës, duke i fituar 18 trofe me gjigantin spanjoll, përfshirë këtu katër Liga të Kampionëve dhe tri La Liga. Mbrojtësi lëvizti drejt "Old Trafford" në verën e vitit 2021 për afro 40 milionë euro, ndërsa i



zhvilloi 95 ndeshje në të gjitha garat. Ai e fitoi Carabao Cup në vitin 2022 dhe në paraqitjen e fundit me klubin nga "Teatri i Endrrave" triumfoi në finale të FA Cup duke e mposhtur rivalin e qytetit, Manchester City në "Wembley" në muajin maj. Varane kishte debutuar për Francën në vitin 2013 dhe me "Trekolorët" i kishte zhvilluar 93 ndeshje, duke e fituar Kupën e Botës në vitin 2018 dhe Ligën e Kombeve më 2021,

ndërsa kishte arritur deri në finale të Botërorit 2022. "Kam rënë dhe jam ngritur mijëra herë, ndërsa këtë herë është momenti të ndalem dhe t'i vendos këpucët në gozhdë. Nuk jam pishman për asgjë. Nuk do t'i ndryshoja gjërat. Kam fituar më shumë se që kam ëndërruar. Mbi të gjitha, jam munduar të isha i sigurt dhe t'i lija gjithmonë gjërat më mirë se që i kam gjetur. Shpresoj që ju kam bërë të gjithëve krenarë", ka përfunduar Varane.

SHKURT

Verstappen: Nuk mund t'i mbyllim gjithnjë garat duke ndjekur rivalët

Max Verstappen u rendit në vendin e dytë në garën e fundit të Formulës 1, atë të zhvilluar në Singapor. Një rezultat që i jep mundësi pilotit të Red Bullit të qëndrojë në krye të renditjes me 52 pikë avantazh ndaj Lando Norris. Kampioni i botës në fuqi e nisi garën nga vendi i dytë dhe e mbrojti atë pozicion deri në fund: "Kam qenë gjithmonë vetëm. Jam përpjekur të bëj më të mirën duke mbajtur ritmin deri në fund". "Mendoj se në një fundjavë, ku e dinim se do të luftonim për podiumin, arritja në vendin e dytë është një rezultat i mirë. Është e qartë se nuk jemi të lumtur, por duhet të përpiqemi të përmirësohemi gjithnjë e më shumë dhe kjo është ajo që do të përpiqemi të bëjmë në vijim", ka deklaruar Verstappen. "Duhet të vazhdojmë të shtyjmë për ta kthyer situatën në favor. Nuk mund t'i mbyllim të gjitha garat kështu, në ndjekje apo të dytët. Të shohim si do të shkojnë gjërat. Tani mezi pres të pushoj dhe të rikuperojmë për pjesën e fundit të sezonit", ka përfunduar Verstappen.

Xavi refuzoi ofertën e Romës

Xavi Hernandez ishte ndër ata që refuzoi Romën në fillim të këtij muaji, sipas Ivan Zazzaroni të "Corriere dello Sport". Ish-trajneri i Milanit, Stefano Pioli dhe trajneri aktual i Ajaxit, Francesco Farioli, me sa duket bënë të njëjtën gjë. AS Roma përfundoi duke zëvendësuar Daniele De Rossin me ish-trajnerin e Torinos, Veronës dhe Genoas, Ivan Juric. Xavi më herët ishte i lidhur me Milanin, Ajaxin, madje edhe Chelsea e Manchester Unitedin. Ish-trajneri i Barcelonës është në pushim pasi u shkarkua muaj më parë nga Barcelona.

Szczesny pranon ofertën e Barcelonës, zyrtarizmi javën tjetër

Në Spanjë e bëjnë të sigurt: Wojciech Szczesny ka pranuar ofertën e Barcelonës, do të jetë ai zëvendësuesi i Ter Stegenit. Pavarësisht se pak kohë më parë, polaku vendosi të largohej nga futbollli, oferta e klubit blaugrana e ka bindur për t'i veshur edhe një herë dorezat. Sipas "Mundo Deportivo", Szczesny pritet të bëhet zyrtarë javën e ardhshme. I pyetur mbi këtë transferim, ish-portieri i Joves nuk pëlqeu të komentojë, por shtoi se i vetmi mendim për momentin shkon për Ter Stegenin duke i uruar gjermanit rikthim sa më të shpejtë. "Diario AS" ka një tjetër version, me të përditshmen spanjolle që shton se për firma po vonon pas Szczesny ka një klauzolë me Juven nëse rikthehet shpejt të luajë, pra duhet të derdhin një shumë në arkën e "Zonjës së Vjetër".

Reali konfirmon lëndimin e Mbappes

Kylian Mbappe u lëndua në ndeshjen ku Real Madridi shënoi fitore me rezultat 3-2 ndaj Alavesit. "Los Blancos" ka konfirmuar lëndimin e yllit francez: "Pas analizave që i janë bërë sot lojtarit tonë Kylian Mbappe nga shërbimet mjekësore të Real Madridit, ai është diagnostikuar me një dëmtim në bicepsin femoral të këmbës së majtë. Evolucioni në pritje". Ende nuk dihet periudha se sa do të mungojë Mbappe në fushat e blerta, ndërsa raportohet se mund të mungojë deri në tri javë.

Guardiola: Rodri, i pazëvendësueshëm

Mesfushori i Manchester City, Rodri, u lëndua në derbin ndaj Arsenalit. Trajneri Pep Guardiola pas ndeshjes kundër Watfordit, për Kupën e Ligës, të cilën "qytetarët" e fituan 2-1, ka

thënë se mungesa e mesfushorit spanjoll është e pariparueshme. "Ne ende nuk e kemi kohën e saktë të mungesës së tij, por do të jetë shumë e gjatë, pavarësisht se njerëzit e tjerë na

thonë se mund të jetë më e shkurtër sesa pritej. Për momentin, nuk jam i sigurt, jemi në pritje të analizave më të fundit për të kuptuar se çfarë lloj operacioni do të jetë i

nevojshëm. Ne nuk e donim këtë, por u besoj lojtarëve që kam dhe detyra ime është të gjej një zgjidhje. Rodri është i pazëvendësueshëm, ka kohë që nuk mund ta zëvendësoh

mesfushorin më të mirë në botë. Është një humbje e madhe për ne, por ky është futbollli. Më duhet të gjej një zgjidhje që të mbetemi konkurrues si vitet e fundit", ka thënë Guardiola.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "AID" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810550633 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "AID" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810550633 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "AID" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 810550633 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Naxhije FIX" Sh.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811876799 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Naxhije FIX" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811876799 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Naxhije FIX" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811876799 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Burim Tanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Vëllezërit Frashëri " Planej.
- Bajram Tanaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Vëllezërit Frashëri " Planej.
- Melisa Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Gani Saramati " Prizren.
- Destan Cabrati shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Vëllezërit Frashëri " Planej.
- Emine Kuleta shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LOKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar/e Administrativ/e për Komisionet të Përhershme (1) pozitë
I raporton:	Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa
Niveli i pagës:	5.78
Orët e Punës:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës:	Në kohë të caktuar 6 muaj me mundësi vazhdimi (puna provuese 3 muaj)
Vendi Punës:	"Instituti A" QKUK, 10 000 Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbledhjet e komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërliken me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi.

Kualifikimet:

- Të ketë të përfunduar fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
- Një (1) vitë përvojë pune në administratë;
- Preferohen kurse dhe trajnime gjatë karrierës profesionale;

Aftësitë:

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Etikë në punë dhe integritet.

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: info@omk-rks.org

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i OMK-së [Formulari i aplikimit](#)
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;

- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Konkursi publik është i hapur deri më 10.10.2024;
- Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
- Faza e testit me shkrim 10 ditë pas fazës së verifikimit;
- Faza e intervistës deri në 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;
- Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

- Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit (testim me gojë);
- Testi me shkrim - maksimumi 70 pikë;
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- Jetëshkrimi - maksimumi 10 pikë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 26.09.2024 deri më 10.10.2024 në ora 23:59.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Na osnovu člana 57. Zakona br. 04/L-150 o komorama zdravstvenih radnika, člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i člana 5. i 7. Administrativnog uputstva (MFRT) br. 01/2024. o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Lekarska komora Kosova raspisuje ovaj:

KONKURS o popunjavanu radnog mesta

Naslov radnog mesta:	Administrativni službenik/ca za Stalne komisije (1) pozicija
Izveštava:	Rukovodiocu Kancelarije za administraciju i finansije
Nivo plate:	5.78
Radno vreme:	40 sati nedeljno
Trajanje ugovora:	Na određeno vreme 6 meseci sa mogućnošću nastavka (probni rad 3 meseca)
Radno mesto:	"Institut A" KUCK, 10 000 Priština

Opšte dužnosti:

- Učestvuje na sastancima organa Komore i stalnih komisija Komore u cilju pružanja pomoći;
- Vodi evidenciju o sastancima stalnih komisija Komore i drugih organa gde se zahteva;
- Obezbeđuje potrebne materijale za nesmetano odvijanje sastanaka stalnih komisija;
- Vodi i priprema zapisnike sa sastanaka;
- Održava dosjee stalnih komisija;
- Pomaže članovima komisije u kontaktima sa drugim organima LKK-a kao i drugim stranama;
- Brine o razvoju procesa koji se vežu sa odlučivanjem komisija Komore; i
- Obavlja i druge poslove iz oblasti odgovornosti i prema potrebama organa Komore i stručne službe uopšte.

Kvalifikacije:

- Da ima završen fakultet u relevantnim oblastima, nivo bačelor;
- Jedna (1) godina radnog iskustva u administraciji;
- Poželjni su kursevi i obuke tokom stručne karijere;

Sposobnosti:

- Sposobnost sprovođenja postupaka i administrativnih uputstava za obavljanje radnih dužnosti;
- Dobro poznavanje rada sa računarom Word, Excel, Internet i drugim tehničkim sredstvima u kancelariji, fotokopir aparatom;
- Komunikacijske veštine, uključujući sposobnost tumačenja informacija, da daje uputstva i prosleđuje informacije kod drugih;
- Da bude energičan, da ima inicijativu i kreativnost pružajući nove ideje u raznim pitanjima u vezi sa radnim procesom;
- Da bude fleksibilan i pozitivno odgovori na promene;
- Poznavanje engleskog jezika se smatra prednošću;
- Veština rada u grupi, pod pritiskom i da dokaže fleksibilnost na poslu;
- Etika na poslu i integritet.

Način apliciranja:

Apliciranje se vrši samo elektronskim putem na adresu: info@omk-rks.org

Kandidati koji konkurišu moraju tačno napisati adresu, broj kontakt telefona kao i email adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na dalje postupke zapošljavanja.

Dokumenti koji se trebaju priložiti:

- Aplikacija LKK-a [Formular apliciranja](#)
- Kopija lične karte;
- Kopija diplome zahtevane konkursom izdate od obrazovnih institucija Republike Kosova. Ako je diploma stečena izvan zemlje, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt koji dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome podnosi do momenta potpisivanja akta za imenovanje na poziciji;

- Kopije dokaza o zaposlenju (potvrda/ugovor) izdate od odgovarajuće institucije za zapošljavanje za radno iskustvo, koje utvrđuju radnu poziciju kao i trajanje angažovanja na toj poziciji. Dokaz o zaposlenju van javnih institucija mora biti potkrepljen najmanje jednim od dokaza kao u nastavku: izveštaj plaćanja u penzijski štedni fond ili izveštaj plaćanja poreskih obaveza u skladu sa zakonodavstvom o porezu na lične prihode.
- Dokaz o pohađanim stručnim obukama ili obukama koje je aplikant realizovao u svojstvu trenera.

Približni kalendar postupka zapošljavanja:

- Javni konkurs je otvoren do dana 10.10.2024.;
- Faza prethodne verifikacije aplikacija do 7 dana;
- Faza pismenog testa 10 dana nakon faze verifikacije;
- Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;
- Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervjuja.

Beleška: Aplikacije koje pristignu nakon roka utvrđenog u konkursu i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Način ocenjivanja i kriterijumi bodovanja:

- Ocenjivanje kandidata se odvija putem pismenog testiranja i intervjuisanja (usmeno testiranje);
- Pismeni test - maksimalno 70 bodova;
- Intervju - maksimalno 20 bodova;
- Životopis - maksimalno 10 bodova.

Lekarska komora Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Republike Kosova i pozdravlja aplikacije od sva lica muškog ili ženskog pola i svih zajednica u Republici Kosova.

Oglas je otvoren od dana 26.09.2024. do dana 10.10.2024. u 23:59 časova.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel.:049/872-300 ili 038/544-872.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

